



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9, datë 30.07.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës  
“Labëria”( Ora 10<sup>15</sup> )

Marrin pjesë:

- |                      |                    |
|----------------------|--------------------|
| 1.Vullnet Bilbilaj   | 22.Simo Petromilo  |
| 2.Ledja Shollaj      | 23.Arsen Belaj     |
| 3.Rajmonda Zoto      | 24.Vjola Xhafaj    |
| 4.Edison Kapaj       | 25.Eglantina Aliaj |
| 5.Myzafer Elezi      | 26.Brikena Sika    |
| 6.Gjergji Nika       | 27.Elca Bezhani    |
| 7.Bujar Osmanaj      | 28.Briseida Çakëri |
| 8.Edlira Kapllanaj   | 29.Eneida Vera     |
| 9.Besmir Brahimaj    | 30.Aurora Qarri    |
| 10.Endri Hyseni      | 31.Grigor Dede     |
| 11.Atird Hoxha       | 32.Shkëlqim Leskaj |
| 12.Ervis Moçka       | 33.Anisa Ceno      |
| 13.Liljana Breshani  | 34.Eda Begaj       |
| 14.Novrus Rrokaj     | 35.Geron Gunbardhi |
| 15.Frosina Qyrdeti   | 36.Anxhela Shenaj  |
| 16.Lorel Canaj       | 37.Refie Laze      |
| 17.Evis Allushi      | 38.Alta Haluci     |
| 18.Englantina Imeraj | 39.Simbol Pazaj    |
| 19.Jerina Dervishaj  | 40.Sokol Kushta    |
| 20.Ardian Musta      | 41.Ilir Aliaj      |
| 21.Roland Strakosha  |                    |

Mungojnë :

- 1.Elpiniqi Mërkuri
- 2.Brikena Puka
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Liri Dëma
- 5.Klodian Xhyheri
- 6.Erëmal Arapi
- 7.Dikens Bushaj
- 8.Marsela Dashi
- 9.Arjan Isufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/1, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Meqenëse kuorumi është, fillojmë mbledhjen.

Zoti Kryetar është i pranishëm dhe do të prononcohet për gjendjen e zjarrit në fushën e mbetjeve.

Z. Ermal Dredha /Kryetar i Bashkisë– Përshëndetje!

Për të bërë me dije dhe komunitetin, si kryetar i bashkisë dhe qytetar i Vlorës. Para 4 ditësh ..ditën e parë ku ka pas prezencë të zjarrit në fushën e mbetjeve. Aty ka roje gjithë kohën, ka ndriçim, jo kamera. Sipërfaqja prej 128 mijë m dhe, është e vetmja zgjidhje për momentin, 600 ton mbetje në ditë. Është menaxhuar situata , ka pas shpesh prezencë zjarri. Me kapacitetet që kemi , është e pamundur të menaxhohej, pasi ka pasur edhe erë. Tymi ishte dhe për shkak të kushteve klimatike. Bëmë dhe takim urgjent me Prefektin ,DEC, kemi pasur ndihma. Lufta ka vazhduar prej 3 ditësh. Tymi ka qenë prezent. Meqenëse s’kemi zgjidhje për momentin.Proçedurat për Landfilldin , nuk janë në dorën tonë. Nuk është çështje, duam apo s’ duam ne, ka ca hallka.

Propozimi për atë proçedurë , ka kaluar në Ministrinë e Kulturës dhe Mjedisit. Është marrë vendim.

Na hapin një dritë jeshile për menaxhimin e Sherishtës. Janë dy momente :

1.Të përmbyllen gjithë punimet.

2.Të hapim qelizën e parë.Kemi bërë punën tonë , të bëhet sa më shpejt e mundur për menaxhim...Por që të hedhësh baltë në rrjetet sociale.... të vijë gjithë, të shohin çfarë pune është bërë, çfarë ndodhi.

Ju përulëm me respekt gjithë strukturave që kanë qenë prezentë . E ndiej si detyrë të them , kush e ndjen dhe i dhëmb, le të vijë dhe të kontribojë , jo të hedhë baltë mbi punën e bërë. Jam falenderues, ndaj :

1.Firmës ”Duka” Sh.P.K , ka kontribuar me mjetet dhe shpenzimet e veta( z.Taulnat)

2.Drejtori i NSHP.

3.Kompania “2A”, që punon për aeroportin e Vlorës.

4.Kompania “ANCOR”

5.Individ, quhet Landi, me mjetet e veta.

6.” Hanxhari” Group .

7.Zotin Ardian Skëndaj me mjetet e vjetra.

8.Ministria e Mbrojtjes.

Zjarre ka pas kudo në të gjithë vendin.

9.Zotin Flamur Isufaj, që kontriboi me mjete të marra hua.

Kjo është më shumë për ti kërkuar ndjesë gjithë qytetarëve të qytetit të Vlorës . Ajo gropë ka 40 vjet. Punuam dhe ndihmuam shumë. Probleme të tilla ndodhin kudo. ..Por për të përballuar situatën e krijuar , prapë do jemi në tërren. Landfilldi i Sherishtës do të hapet , nuk janë fjalë. Duhet të jemi dhe ligjërish dakort. Faleminderit dhe ndjesë.

Z.Novrus Rrokaj – Në emër të këshillit të bashkisë, mirënjohje për të gjithë kontribuesit, që ndihmuam në fikjen e zjarrit. Faleminderit.

Z.Atird Hoxha – Paraprakisht t’ju kërkoj miqësisht që, tonaliteti dhe mirëkuptimi nga ana jonë , janë dy gjëra të ndryshme. Qytetarët e Vlorës, ju kanë votuar për menaxhimin e qytetit. Përsa i përket situatës, është dëmtuar pjesa e turizmit. Përsa i përket gjendjes emergjente të ndodhur në fushën e mbetjeve ...Pra, përgjegjësitë merren me veprime, jo me fjalë.Nuk e di kush është përgjegjës për këtë situatë. Mendoj që kjo nuk është fatkeqësi natyrale, kjo është fatkeqësi politike. Ju prej 1 viti që drejtoni Bashkinë e Vlorës dhe, nuk keni bërë gjë në lidhje me këtë problematikë. Vlora është në pikun e sezonit turistik.Bizneset kanë investuar. Qyteti në tym.Nuk është kjo fatkeqësi natyrale, por është menaxhimi i keq.

-A ka përgjegjës...A ka ndonjë hetim se, pas ca ditësh do të ndodhë prapë . Shumë mirë që kontribuan këto firma , pasi ata kontribojnë për qytetin .Nëqoftëse, këto firma nuk do të kontribonin, si do mundnit ta përballonit ?

Unë mendoj që, për vendimin që thatë për Landfilldin, janë miliona euro që janë investuar. -Pse Landfilldi nuk vihet në funksion ?

-Çfarë kapaciteti ka sot NSHP , për menaxhimin e situatave të tilla. Vlora nuk është vetëm e juaja, por dhe e jona , e të gjithëve. Por nuk bëhemi dot me ju, kur ju digjni dhe turistët anullojnë prenotimet.

Znj.Alta Haluci – Ne nuk duam tu prishim punë as turistëve dhe as vlonjatëve

Ministria e Turizmit qëndron krenare për turizmin, është dhe e Mjedisit. Ne nuk kemi bërë në rrjetet sociale kontra reklamë.

Znj.Anxhela Kapllani – Pse është kaluar 2 herë ...

Pse kalojnë fondet kur Landfilldi nuk funksionon?

Z.Ermal Dredha – Ne jemi për të fikur, jo për të djegur. E sqarova. U menaxhua në kohë nga NSHP. Problem ishte dhe era , e pranishme.

Për të sqaruar gjithë komunitetin. Jemi në kontakt me Policinë e Shtetit, Prokurori e instancat e tjera, për gjetjen e personit dhe të vihet para përgjegjësisë.

-Fondi është parashikuar në kontratë për Sherishtën. Në momentin që na kalojnë kompetencat, do duhen ato fonde. Kontrata na lidh, kontrata na zgjidh. Fondet do të duhen kur të vëmë në punë Landfilldin. Ai fond është për menaxhimin , në vazhdimësi.

Kur të na kalojnë kompetencat , do ti përdorim ne ato fonde. Kemi ushtruar presion me institucionet...ato janë disa ..Lekët janë të parashikuara për të qenë aty.

Znj.Anxhela Shenaj – Ka kaluar afati.

Z.Ermal Dredha – Këtë po them. Është një proces gjyqësor që vendos. Nuk jemi ne.

Idea është , fakti është që në momentin që skemi akoma kompetenca. Është ligji.

Z.Atird Hoxha – Makineritë në doganën e Durrësit ?

Z.Ermal Dredha – Idea është, janë makinat në doganë..Nëse ato buxhete,. janë për tu vendosur në punë ai projekt, jo për ç’doganim. Ato i ka firma. Janë disa mjete. Nuk na lejohet neve ç’doganimi.

Z.Geron Gunbardhi – Falenderim për të gjithë ata që morrën pjesë në fikjen e zjarrit, Zjarrfikësit, NSHP etj, dhe për këta të ketë dhe stimul financiar. Ky ishte një dështim për turizmin, ky është një fenomen i vjetër, por që i duhet gjetur zgjidhje.

Një vit më parë, zoti Isufi , ju tha në lidhje me Landfilldin, është procedurë shumë e madhe, prandaj filloni procedurat. Pra, ne nuk jemi pengesë, kemi kërkuar vendosjen e kamerave. Vlora po ecën vetëm përpara në drejtim të turizmit. Në lidhje me këtë problem, ka pasur dhe persona të shtruar në spital. A s’do të ishte mirë që lekët ti marrin punonjësit e NSHP dhe jo ata të Landfilldit ?

Z.Ermal Dredha – Njerëzit janë pjesë e kontratave, organikës.Është detyrim që ka kontrata. Ishte çështje mjetesh, jo çështje punonjësish.

-Është territor i madh, kamerat nuk funksionojnë kur ka flakë. Kur përmenda pjesën e procedurave ..E kemi ndjekur procedurën sipas ligjit, që kur kam ardhur. Ka ngërçe me institucione të ndryshme. Ajo është një kontratë nga KWF, është me standarte ndërkombëtare. Është në monitorim, auditohet nga KWF. Për punësimet e reja, janë pjesë e organigramës.

Z.Ervis Moçka – U bënë gjithë këto pyetje, sikur s’ka falimentuar ndonjë firmë. Janë normale, ndodhin në shoqëri tregëtare. Është në proces gjyqësor. Është detyrim nga KWF për punësimin e punonjësve. Ne e kemi votuar.

I nderuar zoti Kryetar!

Bëtë mirë që erdhët, që dolët dhe sqaroni qytetarët për gjendjen e krijuar dhe, kjo na shqetëson të gjithëve.

Bëtë mirë që falenderuat ata që punuan dhe kontribuan për fikjen e zjarrit.

Bie dakort, me 2 gjëra për zotin Hoxha...Si mund t’ju ndihmojmë dhe ,

Çfarë kapaciteti ka NSHP? Pra, administrata të bëjë një analizë, si ndodhi, pse ndodhi dhe të vijë për miratim financash. Me gjithë propozimet e këshilltarëve , mungesa e kamerave etj, jam dakort. E përgëzoj zotin Hoxha... dhe dua që në këtë forum qytetar, ti drejtohem njëri – tjetrit me qytetari, me etikë.

Z.Novrus Rrokaj – Shprehje ligjshmërie për mbledhjet e datës 27 qershor dhe mbledhjen e datës 10 korrik.( Lexon )

Vendimet e Këshillit të Bashkisë Nr 49 – 59, datë 27.06.2024 , janë vlerësuar të ligjshëm, dhe VKB Nr 60 – 62 , datë 10.07.2024 janë vlerësuar të ligjshëm.

Z.Gjergji Nika – Sapo dëgjova për shprehjen e ligjshmërisë së VKB Nr 56, datë 27.06.2024. Është i fallsifikuar. U lexuan propozimet nga zoti Strakosha dhe zoti Elezi. Në Nenin 10, nga propozimi i zotit Elezi, keni hequr pikën “a”...Lexon...Ka qenë ose jo ...Ky vendim është fallsifikuar, nuk është miratuar ashtu me ato propozime.

Z.Novrus Rrokaj - Mos është gabim , në zbardhjen e materialit.

Z.Gjergji Nika – Gabimet po përsëriten. Janë dhe 4 vendime që nuk janë zbardhur ashtu siç duhet.

Z.Daut Zëraj – Pika që pretendon këshilltari, është e vërtetë që është zbardhur ashtu, pa atë propozim. U hodh në votë. ..Propozimi i zotit Ilir Aliaj... Ishin dy propozime, jo, pse e vendosëm. U zbardh gabim.

Z.Myzafer Elezi – Është propozimi im si në Komiisonin Juridik dhe në mbledhjen e këshillit, e votuam të gjithë. Ju falenderoj që e votuat. Ky këshill kur miraton, nuk e ndryshon asnjë. Nëqoftëse është lapsus,të korrigojohet, të zbardhet dhe të na vijë me ndryshimet e bëra,rregullorja.

Z.Ervis Moçka – Nëqoftëse është lapsus, le ta ndryshojnë . Dhe ta diskutojmë këtë problemin e zbardhjes , le të mblidhen kryetarët e grupeve, si do veprohet kur ka paqartësi.

Z.Ilir Aliaj – Jam dakort me zotin Nika, që ky y vendim kur të rizbardhet të merret parasysht dhe propozimi im.

Z.Myzafer Elezi – Do ta korrigojnë dhe të na vijë drafti në rregull.

Z.Daut Zëraj – Me një shkresë shoqëruese prefektit , një shtesë ..

Z.Novrus Rrokaj – Vazhdojmë me miratimin procesverbalit të mbledhjes së datës 10 korrik 2024.  
Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 9/2, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Vazhdojmë me rendin e ditës. Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënie të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin qershor 2024”

I kalojmë në votim të dy projektvendimet ?

Votohen.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

**REPUBLIKA ESHQIPËRISË**

**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 9/3, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar , për muajin qershor 2024”.

Votohet.

Pro - 37 vota

Kundër - 0 vota

Abstenim - 0 vota

Miratohet.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/4, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 3 e rendit të ditës, “Për miratimin e tavanëve përfundimtar për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027”.

Nga administrata një relacion.

Z.Kozma Mali – Ky projektvendim është një ndër aktet për përgatitjen e Projektbuxhetit 2025 – 2027, sipas Udhëzimit Nr 23/2018.. Bazuar në Udhëzimin Nr 3/2024, Udhëzimin Nr 8 ...Parashikimi i realizimit të të ardhurave për 2025 – 2027 , jemi bazuar në vitet në planifikimin dhe realizimin në vitet 2022, 2023 dhe parashikimet për vitin 2024. Të dhënat janë miratuar me VKB Nr 28, datë 28.03.2024.

Z.Gjergji Nika – Tavanët përfundimtarë kanë qenë ...gjithë zërat kanë oshilacione. Në faqen 2 me zërat në tavanët përgatitorë kanë luhatje.

Zëri 602 ,për pagat , ju thoni 213018..., në mujain mars 451568.

Z.Kozma Mali – Për të gjitha pyetjet, më bëni kërkesë me shkrim dhe t’ju kthej përgjigje. Ju kemi kthyer përgjigje dhe për tavanët.

Z.Gjergji Nika – Kam studjuar tavanët për 3 vitet e fundit.

Zëri i pagave , 600 – 601 - 380283, në miliona këto , në muajin mars ;

Zëri 15678 ....Të gjithë zërat e tavanëve përgatitorë për muajin mars dhe këto tani, kanë oshilacione. Janë mbartur gabim. Nuk të ndryshon zëri i pagave. Ky , tavanët përgatitorë, i muajit mars, është kot.

Z.Kozma Mali – Ato janë parashikime.

Z.Gjergji Nika – Nuk e quaj normale që vjen drejtori dhe nuk kthen përgjigje në mbledhje.

Z.Ervis Moçka – Është mëse e qartë , jam dakort , që për çdo projekrvendim, drejtorët do të mbrojnë materialet. Përsa i përket tavanëve ,nëse muaji mars është më pak dhe sot më shumë, është bërë mbledhja e Këshillit Konsultativ dhe pagat do të rriten, si minimumi dhe maksimumi. Prandaj pyeta, nëse ka rritje page, po. Nëqoftëse, s’ka, është gabim.

Z.Novrus Rrokaj – Ka ndonjë pyetje tjetër ? – Jo.

E hedhim në votë.

Pro – 29 vota

Kundër -10 vota

Abstenim – 0 vota Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/5, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia si humbjen e jetës së zotit Guri Resulaj, në banesën e zonjës Sose Zhezha dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Ka ndonjë gjë ? – Jo.

E hedhim në votim.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 9/6, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zonjës Evisa Mamushi dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Ka ndonjë gjë ? - Jo.

Votohet.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/7, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi ” Për trajtimin me pagesat e qirasë sipas programeve për strehimin social të zonjës Rukije Shabani, për shkak se, banesa e saj, preket nga zbatimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar , Vlorë “

Votohet.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/8, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e subvencionit të qirasë që përfitojnë familjet dhe individët e prekur nga zbatimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Superstradën Fier – Vlorë “, sipas VKM Nr 254, datë 09.05.2018”.

Nga administrata ?

Znj.Drita Mustafai – Në lidhje me këtë projektvendim, është një listë me 7 persona që kanë aplikuar. Duam të bëjmë dy ndryshime: Zonja Liljana Dino , ka bërë kontratën me EKB për banesë, prandaj do hiqet zonja Liljana Dino dhe vihet, shtohet zoti Agron Lule, një pensionist.

Z.Novrus Rrokaj – Pra, jeni dakort me këto ndryshime ?

Votohet.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/9, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin Planit të Integritetit të Bashkisë Vlorë “.

Relaton nga administrata drejtori juridik.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi ka synim kryesor të sigurojë një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit .....për forcimin e integritetit , janë përcaktuar disa pika të planit si,

-Sigurimi i një shërbimi cilësor tek qytetarët

-Bashkëpunimi sa më i mirë midis sektorëve...

Nga ana e bashkisë, janë përcaktuar dhe objektivat, kemi planin e integritetit

Lexon 4 objektivat...

Z.Myzafer Elezi – Në faqen 6 , hartimi i planit, kalon në Fazën 1..lexon....

A mos vallë nuk ka ndonjë Urdhër nga Kryetari i Bashkisë dhe është lënë pa pasqyruar ..

Z.Daut Zëraj – Kur të zbardhet, do pasqyrohet.

Z.Dorian Demiri – E kemi dorëzuar të korrigjuar.

Z.Daut Zëraj – Në mbledhjen e Kryesisë e konstatuam, dhe kur ta zbardhim do ta vendosim.

Z.Ervis Moçka – Këshilltarët duan material të saktë.

Z.Dorian Demiri – Plani i punës është bashkëlidhur. Planin e kemi, këshilltari thotë për grupin e punës. Pra, doni miratimin e Urdhërit apo planin ?

Urdhëri nuk është kompetenca juaj.

Znj.Edlira Kapllanaj – Dua ta përshëndes këtë plan, në lidhje dhe me ndryshimet në kurikulën e re që doli, në lidhje me antikorrupsionin. Te integriteti, do të shtoja ,..Pra, të ketë një pikëzim dhe të ketë një performancë për të gjithë drejtorët. Duhet ta zbatojnë.

Z.Ervis Moçka – Është detyrim ligjor, e bën Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Znj.Irena Toshkallari – Për përfshirjen në kurikul, nuk është detyrë e bashkisë dhe e këshillit të bashkisë

Znj.Edlira Kapllanaj – Jo, e përshëndeta.

Z.Gjergji Nika – Ky plan do kalojë, është në të mirë të bashkisë. Dua që këtë plan ta monitoroni dhe së bashku me këtë plan, kërkoj dhe monitorimin për konfliktin e interesit në rregulloren e këshillit bashkiak. Monitoroni dhe rregulloren e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Z.Dorian Demiri - E keni për të ardhmen. Reklamojeni konfliktin.

Z.Gjergji Nika – Kam një listë me 1475 punonjës të bashkisë, ku nga këta, ka që s’vijnë në punë fare, që janë jashtë shtetit ...

Z.Novrus Rrokaj – E hedhim në votë.

Z.Dorian Demiri – Urdhër Nr 8942 Prot, datë 06.06.2024, ta shtojmë.

Z.Novrus Rrokaj – Ta shtojmë dhe numrin e Urdhërit Nr 8942 Prot, datë 06.06.2024.

Votohet.

Pro – 40 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 9/10, datë 30.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika “Të ndryshme”.

Z.Myzafer Elezi – Kam disa problematika të marra nga qytetarët.

1-Banorët pranë kopshtit “Sulo Didi”, ankesë , pa pastruar rruga.

2-Në lagjen “Karabash”, banorët ankohen për mungesën e ujit.

A keni dijeni për mungesën e ujit në këtë lagje?

3-Qyteti i Orikumit – Përse në qytet dhe fshat ka mungesë të energjisë elektrike ?

4-Për Drejtorinë e Shërbimeve, Rruga “Dervish Hekali “ në Rajonin Nr 5, është në gjendje skandaloze.

5-Rikonstruksioni i rrugës “Pano Bixhili” dhe tubacionet e ujit të pijshëm.(Bashkëlidhur shkresa)

Znj.Alta Haluci – Pyetje për të gjithë ne , Këshillin Bashkiak Vlorë, që të merrnim eksperiencë nga Këshilli i Bashkisë Sarandë. Një bashki si Vlora, të marrë eksperiencë nga Bashkia Sarandë, bashki më e vogël. Sa para u shpenzuan, këto fonde janë të këshillit, sa morrën pjesë....

Pra, ....Zoti Myzafer ka thënë për rrugën “Dervish Hekali “, është vetëm një pjesës rruge për rikonstruksion.

-Në fondin e bashkisë, përveç lekëve të nxënësve ekselentë ,... Komisioni i Arsimit nuk është mbledhur, vetëm një herë..Ka nxënës që janë fitues të olimpiadave, çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Pra, duhet bërë ndonjë ndarje midis nxënësve të shkëlqyer dhe atyre fitues të çmimeve. Doja një përgjigje. Prandaj, them të mblidhet Komisioni i Arsimit.

Z.Novrus Rrokaj – Për vizitën në Sarandë, Kryetarja e ka diskutuar shumë herë. Vajti thua jse 1 vit ky diskutim. Ftesa ka qenë për të gjithë.

Znj.Irena Toshkallari – Për nxënësit fitues të olimpiadave po bëhet një projektvendim dhe së shpejti do ta sjellim në këshill.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. Për mbledhjet e komisioneve të gjithë mblidhen, kanë datën dhe orën dhe, nëqoftëse duan komisionet e tjerë ...

Z.Atird Hoxha - Sa drejtorë kemi të pranishëm, për pikën “Të ndryshme “.. Një shqetësim nga



banorët e zonës së Dukatit që, janë përballur me arrogancën e një firme, për marrjen e ujit për në resort. Pra, kush mbulon ujësjellësin, Çfarë procedurash janë ndjekur për të marrë ujin Kjo zonë reagon sa herë ka një padrejtësi. Duke qenë një territor nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë, Drejtori i Ujësjetillësit, çfarë është kjo procedurë dhe pse ka ndodh ky incident ? Është një problem real.

-Pretendohet për rrugën “Dervish Hekali “,.. bashkia nuk i ka trajtuar. Janë qytetarët që na kanë kontaktuar , për jetë të keqe, rruga shumë e keqe. Ndoshta ndonjë projekt i bashkisë.

-Zona Tragjas – Hotel “Paradajs”, ka probleme me furnizimin me ujë të pijshëm . Është zonë turistike dhe, në pikun e turizmit të ketë mungesë të ujit të pijshëm për 12 orë. Uji është jeta.

Z.Arsen Belaj – Në lidhje me turizmin, unë jam i përqëndruar dhe, e them shpesh që , Vlora s’është vetëm këtu.

-Plehrat janë në mes të sheshit të Orikumit. Tenderi ka mbaruar. Mbeturinat janë në gjendje shumë të keqe.

-Dritat, shumë problem.Nga Tragjasi në Palasë, le të nxjerrin një fidër dhe për banorët. Drita s’kemi, ujë jo.

-Në buxhetin e vitit të kaluar, kaluan rruga e Radhimës dhe rikonstruksioni i shkollës.

Z.Klaudio Mehmetaj – Janë hedhur në proces tenderimi.

Z.Arsen Belaj – Hidhni vështrimin dhe nga ne. Rruga copë dhe pa pastruar, S’është Vlora vetëm Lungomare. Nuk pastrohet.

Z.Sokol Kushta – Meqenëse, u hap çështja e Dukatit, doja të ishte administratori prezent. Kam qenë atje. Është një konflikt në Dukat. Është zonë e bashkisë sonë.Mos të politizohet.Kush ka firmosur që ai fshat të ngelet paujë ? Asnjë s’ka firmosur që ky fshat të ngelet pa ujë, të merret uji. Sot administratori të ishte këtu. Duhet të japim zgjidhjen e çështjeve, mos ta politizojmë.

Z.Endri Hyseni – Në lidhje me Klubin e Futbollit “Flamurtari “.Për zhvillimin e garave sportive 2023 – 2024, të cilat përfunduan në prill 2024. Kontrata është në skadencë.

Është paraqitur dhe një kërkesë nga Klubi i futbollit për shtyrjen e kontratës deri në përfundim të procedurave të shitjes së asetëve.

Z.Atird Hoxha – Duhet të kemi një relacion çdo 3 muaj.

Z.Endri Hyseni – Në mbledhjen e radhës do keni raportin financiar, për vlerësimin e aksioneve. Klubi duhet të rregjistrohet në garat sportive. Vetë administrata ka reaguar.Do vijë në këshillin e bashkisë raporti i vlerësimit për miratim.

Z.Gjergji Nika – Në Konferencën e Kryetarëve, e lamë që të ishte prezent Drejtori i Ujësjetillësit . Problemet që ngritën zoti Elezi dhe Hoxha , s’kemi përgjigje..Ujësjetillës – Kanalizime, ka gjet një mënyrë tjetër për të rritur të ardhurat , me anë të gjobave. Faturat nuk duhet të vonohen mbas datës 10. Kamatvonesa është shumë e madhe dhe goditen qytetarët. Është muaji i dytë, që faturat dalin në datën 26 dhe në datën 28, kamatvonesat ...Kur unë dorëzoja ngritjen e komisionit të përhershëm , më thatë zoti Moçka se, do sillnit drejtorin për të na sqaruar.

Z.Ervis Moçka – Nuk rrëzoja komisionin.I vazhdoni kërkesat tuaja. Them , le të vijnë , e kanë detyrë morale dhe ligjore, të vijnë të na përgjigjen për gjithë problematikat.

Për faturat, ka pas probleme në sistem, më tha drejtori. Penalitetet le ti heqin, meqenëse e ka fajin sistemi.

Znj.Rajmonda Zoto – Shqetësim , ankesë, kërkesë nga banorët e Pallatit 1289, në Rajonin Nr 4. Tejet i amortizuar në pjesën e jashtme dhe të brendshme . rënie të suvasë, dalje të hekurave, ka çarje të mureve. Banorët kanë ngritur këtë shqetësim, për një investim për rikuperimin e pallatit.

-Përgjatë rrugëve shohim mbetje. Çdo biznes prodhon mbetje. A paguajnë taksat këto biznese, apo kanë ndonjë kontratë për ti marrë bashkia, ku ata i depozitojnë.

-Shqetësim, për problemin e nxënësve, jo vetëm për ata me rezultate të larta, jo vetëm në mësim por dhe rezultate të larta në sporte të ndryshme. Le të motivohen dhe ata.

Znj.Irena Toshkallari – Faleminderit zonja Rajmonda.Do ti përfshijmë në këtë projektvendim.

Z.Edison Kapaj – Në fshatin Bestrovë , ka ndodhur një ngordhje masive e peshkut në liqen.

Kontaminuar gjithë zona. Pijnë ujë dhe bagëtia. Deri tani nuk është marrë asnjë masë, është shqetësim i madh, duhet të hiqet i gjithë peshku dhe të gjendet shkaku, pse ka ndodhur.

- Në 4 fshatra ,(Bestrovë – Oshëtimë – Panaja – Kërkovë ) në Njësinë Qendër, pompat nuk sjellin dot ujin.Ujësjellësi i ri nuk është vënë në efikasitet, marrin shumë pak ujë.

Znj.Aulona Veizi – Këshilltari ka telefonuar, dhe zoti Gernard. Kemi kontaktuar me AKU, DSHSH për peshkun pse ka ndodhur dhe të merren masa. Po merremi me këtë problem, po marrim masa për evitimin..

-Në lidhje me problemin e zhurmave, kur ka shkuar specialistja, në kushte normale, nuk ka zhurmë.

Z.Atird Hoxha – A kenë, jeni në dijeni , a është i licencuar subjekti?

Znj.Aulona Veizi – Nuk është problemi ynë, ne kemi matjen e zhurmave, pra specialisti i mjedisit, pajisjen për matjen e zhurmave.

Z.Atird Hoxha – A është i licencuar? Ushtrohet aktivitet.

Znj.Elca Bezhani – Të shkojë për verifikim Policia Bashkiake, Drejtorja e Tatimeve.

Z.Atird Hoxha – Unë ngre një shqetësim, strukturat le ta verifikojnë.

Z.Novrus Rrokaj –Duke pasur dhe shprehur këto shqetësime, do t’ju jepet përgjigje, qoftë dhe me shkrim. Duke ju falënderuar për mbledhjen e sotme, mirutakofshim në mbledhjen tjetër.